



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

09 shtator 2019

C-IV-14-0239

Ankuesi

NSH “K”, përfaqësues P.T.
Përfaqësuar nga avokati

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 09 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN052-0418, të datës 06 dhjetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Ankuesit i caktohet taksa gjyqësore për ankesën e ushtruar, në shumë prej 70 €, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi..**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 14 janar 2014, ankuesi përmes të autorizuarit të tij, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN052-0418, të datës 06 dhjetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (me tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për furnizim të NSH-së “F” me produkte të

ndryshme të cilat kanë qenë të nevojshme. Ankuesi ka pohuar se nga bashkëpunimi afarist mes tyre ka mbetur pa u paguar shuma prej 100,000.00 € për periudhën prej muajit nëntor 1996 deri në muajin dhjetor 1999, fatura të cilat nuk janë paguar për shkak se ndërmarrja kishte hyrë në proces të privatizimit dhe se bazuar në këtë nuk ka bërë kërkesë të veçantë lidhur me pagesën e faturave, pasi që nuk jeton në Kosovë dhe nuk ka pasur mundësi se si të informohet, si shumë persona edhe ankuesi është dëmtuar nga rrethanat e jashtëzakonshme në Kosovë të cilat gjykata duhet ti ketë parasysh, po ashtu ankuesi ka pohuar se është vënë në lajthim nga AKP-ja lidhur me mosparaqitjen e kërkesës, para shpalljes së likuidimit. Në mbështetje të kërkesës së tij ka, si provë ka bashkangjitur kopjen e vendimit të atakuar.

Me 29 shtator 2015, ankuesi përmes parashtrësës ka bërë plotësimin e ankesës, në të cilën ka kërkuar që gjykata përveç kërkesëpadisë të miratojë kamatën dhe shpenzimet e procedurës në këtë çështje kontestimore.

Me 05 shkurt 2016, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se kundërshton si ekzistencën e detyrimit edhe shumën e kërkuar dhe thekson rregullin kryesor të procedurës civile se paditësi ngarkohet me barrën e provës, po ashtu AKP-ja ka pohuar se paditësi nuk ka siguruar asnjë provë në mbështetje të kërkesës dhe nuk ka arritur të kundërshtojë disa prej argumenteve ligjore të përcaktuara në vendimin e AL-së, andaj propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN052-0418, i datës 06 dhjetor 2013, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 71.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKM-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH “F” kishte hyr në proces të likuidimit nga data 4 korrik 2006. AKM kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH “F” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 26 shtator 2006. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor “Koha Ditore” me datat 26 korrik 2006 dhe në web sitin e AKM-së.

Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën e tij Autoritetit të Likuidimit ia kishte parashtruar me datë 03 nëntor 2006.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij te Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKM-ja. Ankuesi në ankesë nuk ka sjell asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit, mandej nuk është ndalur fare në arsyetimin e vonesës.

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 26 shtator 2006, e deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij me 03 nëntor 2006 në Autoritetin e Likuidimit, ka kaluar më shumë se një muaj. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (C-IV-13-0003, C-IV-13-0652, C-IV-13-1754, C-IV-13-2063 dhe AC-I-14-0090) për refuzimin e ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditore janë parashtruar jashtë afatit për paraqitjen e tyre në AL.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 58.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Në pajtim me nenin 63 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe në pajtim të nenit 13.4 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, taksa gjyqësore në shumë prej 100.00 € caktohet për ankuesin. Meqenëse ankuesi ka paguar shumën prej 30.00 €, më 14 dhjetor 2018, tani obligohet që të paguaj pjesën e mbetur prej 70.00 €, ashtu siç është caktuar në pikën dy të dispozitivit.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Aktgjykimi duhet t'i dorëzohet palëve.